

## UDHËZIME PËR KANDIDATET BLERËS

### 1. Mënyrat e komunikimit me ofertuesit

I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit (korrespondenca) ndërmjet Autoritetit Shitës dhe Kandidateve blerës duhet të bëhet me shkrim.

Në veçanti, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit kryhet nëpërmjet postës, mjete elektronike. Do të konsiderohet se korrespondenca është dorëzuar në kohën e duhur, nëse përmbajtja e saj, me shkrim, ka mbërritur tek Autoriteti Shitës para skadimit të afatit kohor.

Dokumentat e Ankandit mund të tërhiqen në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), Këshilli i Ministrave, pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë kundrejt pagesës prej 1000 (një mijë) lekë, në Bankën Raiffeisen, në Nr. 0103030780 dhe IBA AL 7220211013 00000000 103030780 ose në faqen zyrtare të internetit të DSIK-së, [w.nsaalbania.gov.al](http://w.nsaalbania.gov.al), pa pagesë.

### 2. Hartimi i ofertës

Kandidatet blerës janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Ankandit. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DA do të refuzohen si të papranueshme.

Kandidatet blerës përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti shitës nuk është përgjegjës për këto kosto.

Oferta dhe të gjithë dokumentet e korrespondenca që lidhet me ofertën, e shkëmbyer ndërmjet Kandidatit blerës dhe Autoritetit shitës duhet të përgatiten në gjuhën shqip.

Për të organizuar takimin ju lutem kontaktoni: Komisioni i Ankandit Publik, duke dërguar me parë një kërkesë me shkrim në adresën: [sekretaria.nsa@mod.gov.al](mailto:sekretaria.nsa@mod.gov.al)

Originali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar.

Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së ankandit (Prokura mund të përfshijë edhe autorizimin për të nënshkruar një kontratë).

### **3. Oferta duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:**

- a) Formularin e Ofertës.
- b) Kërkesën për të marrë pjesë në procedurën e ankandit.
- c) Dokumentet dhe vërtetimet e përmendura në pikën 8 të DA.

Një Kandidat blerës duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

### **4. Fshehtësia**

Autoriteti shitës nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga kandidatët blerës ose ofertuesit, të etiketuar si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Kandidatet blerës duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për blerjen e automjeteve të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar".

**"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I ANKANDIT, DHE JO PARA datës 28 qershor 2010, orës 10.00"**.

### **5. Llogaritja e çmimit**

Kandidati blerës duhet të plotësojë Formularin e Ofertës.

Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek.)

Ofertuesi duhet të shënojë në Programin e Çmimit çmimet totale të ofertës.

Çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm, dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor si e papranueshme.

### **6. Afati kohor dhe vendi për dorëzimin e ofertave**

Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë, Kati i dytë.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave skadon më **28.06.2010**, në orën **10:00**.

Ofertat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i rikthehen të pahapura kandidateve blerës përkatës.

Në rastin e prokurimit elektronik afati kohor për dërgimin e ofertës skadon në momentin e orës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor për hapjen e ofertave.

### **7. Data dhe vendi për hapjen e ofertave**

Hapja publike e ofertave do të kryhet në momentin e fillimit të ankandit publik, në ambientet e DSIK-së, më datë, **28.06.2010**, në orën **10:00** ora, Kati i dytë.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre duhet të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave.  
Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave duhet t'i

komunikohet të gjithë Kandidateve blerës te pranishëm. Oferta me vlerën me të lartë do të shërbeje si vlerë fillestare e fillimit të procedurës së ankandit publik.

## **8. PJESMARRJA DHE KUALIFIKIMI**

### **1. Kërkesat për kualifikim dhe vërtetimet e kërkuara**

Kandidatet blerës duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për tu kualifikuar:

- a) dokumentin e identifikimit, një kopje e noterizuar e të cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit

Kërkesa të veçanta.

- a) vërtetimin e vendbanimit

### **2. Bashkimi i kandidateve blerës**

Oferta mund të paraqitet nga një grup kandidatesh blerës, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë ekzekutimit të kontratës.

Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht me anë të një marrëveshjeje të noterizuar, në të cilën tregohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes dhe sasia e mallrave konkrete për secilin anëtar, si dhe autorizimi/prokurën për përfaqësimin e anëtarëve të grupit, si për dorëzimin e ofertës ashtu edhe për lidhjen e kontratës në rast të shpalljes fitues.